

VENDIM
Nr. 57, datë 27.12.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 3, DATË 30.1.2023, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS"**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (rregullorja e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 27.12.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 3, datë 30.1.2023, 'Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës'"

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës, me shkresën nr. 1007 prot., datë 11.12.2023, me lëndë "Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës, me vendimin nr. 3, datë 30.1.2023, "Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura".

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës, z. Sahit Doçi, ka përfunduar studimet e larta për ekonomi industriale, Tiranë, në vitin 1984.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit të KKRR-së nr. 3, datë 30.1.2023, "Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Kukës" bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor: z. Sahit Doçi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani